



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Datë: 22.08.2023
02 Nr.400/01-21770/23

PROCESVERBAL

**Dëgjimi Buxhetor në Dragash, me banorët e Dragashit, Shajnes,
Xërxes, Radeshës, Leshtanit, Libevishtës, Kukajanit, Mlikës,
Vranishtës, Rapçës**

**I mbajtur më 22.08.2023, e martë, duke filluar nga ora 17:00
VENDI: Salla e Asamblesë Komunale në Dragash**

Njoftimi për këtë Dëgjim Buxhetor është publikuar:

Në uebfaqe zyrtare të Komunës më 14.08.2023:

Shqip: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Degjimi-Dragash.pdf>

Boshnjakisht: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2023/08/Rasprava-Dragash.pdf>

Në Facebook-un zyrtar më 19.08.2023:

Shqip: <https://www.facebook.com/photo.php?fbid=641410261421494&set=pb.100066575766996.-2207520000&type=3>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/photo/?fbid=641411694754684&set=pb.100066575766996.-2207520000>

Në këtë takim nga Kabineti i Kryetarit të Komunës morën pjesë:

1. Bexhet Xheladini - Kryetar
2. Qamil Kolloni – Drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim
3. Vetim Ramadani – Drejtor i Administratës
4. Veton Halili – Shef i Kabinetit
5. Fari Kolloni – Zyrtar për Informim

Pjesëmarrës në këtë dëgjim buxhetor kanë qenë gjithsej 24 persona, të cilët janë nënshkruar në Listën e pjesëmarrësve. Prej tyre kanë qenë:

1. Femra: 2
2. Meshkuj: 22

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Dragashit, Bexhet Xheladini

Bexhet Xheladini: Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit! E vlerësoj prezencën tuaj në këtë dëgjim buxhetor. Është obligimi ynë si ekzekutiv që ta prezantojmë para jush projekt-buxhetin për vitin 2024, ndërsa prezenca juaj këtu është përmbushje e një obligimi moral e qytetar. Këtë vit buxheti është më i madh se vitin e kaluar. Pas këtyre dëgjimeve buxhetore, ku do t'i marrim kërkesat dhe sugjerimet e juaja, në shtator do ta finalizojmë draft-buxhetin dhe do t'ia paraqesim Asamblesë Komonale për miratim. Pjesa më e rëndësishme e buxhetit për ne është ajo e investimeve kapitale. Këtë vit do të kemi më pak ndarje buxhetore nëpër fshatrave, për shkak se shumica e buxhetit do të destinohet për projektin e Ujësjiellit kryesor, dhe një pjesë tjetër për ndërtimin e fabrikës së ujit. Me ardhjen në pushtet e kemi ritenderuar projektin e Ujësjiellit, pa ndryshime. Ky rrjet do të kushtojë afërsisht 2.5 milionë euro.

Qamil Kolloni, drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim prezanton para të pranishmëve Listën preliminare të shpenzimeve kapitale të parapara për vitin 2024.

Kërkesat e qytetarëve

Bekri Qusaj, banor i Dragashit:

- Kërkojmë që të intervenohet në riparimin e kanalizimit mbrapa Gjykatës në Dragash dhe një gyp tjetër i kanalizimit që është i dëmtuar, nga Biblioteka deri para Shkollës 'Fetah Sylejmani'.
- Problem tjetër është një gyp i ujësjiellit te lagja mbrapa Spitalit (QKMF-së).

Selldin Jelmazi, banor i fshatit Radeshë:

- Prioritet për fshatin Radeshë është investimi në disa rrugë të fshatit.
- Një problem tjetër për fshatin Radeshë është mungesa e parkingjeve.

Ajhan Beciri, përfaqësues i fshatit Rapçë:

- A ka ndonjë plan konkret për zhbllokimin e rrugëve në qytezën e Dragashit?

- Çfarë do të bëhet me rrugët e uzurpuara, pronat e interesit publik në Dragash nuk mund të shfrytëzohen?
- Në Dragash na duhen polica të shtrirë në rrugë, vozitet shumë shpejt dhe rrezikohet siguria e këmbësorëve.

Fergap Zaimi, banor i fshatit Radeshë:

- Kërkoj që të riparohet rruga rreth 200 metra te vendi nën Xhaminë. Është me kubëza të vjetëruara dhe është e rrezikshme për vetura.

Zinaida Elmazi, banore e fshatit Mlikë:

- Prioritet në fshatin Mlikë është ndërtimi i një ambulance për fshatin, ku do të punësoheshin edhe 2-3 punëtorë.
- Prioritet tjetër për fshatin është kubëzimi i rrugëve.
- Propozoj që të përkrahen dhe subvencionohen gratë të cilat merren me mbrojtjen dhe promovimin e traditës gorane.

Kamber Kamberi, banor i fshatit Rapçë:

- Është bërë hapja e disa puseve për gjetjen e ujit, deri ku ka arritur realizimi i këtij projekti në fshatin Rapçë?

Elvin Memisi, banor i fshatit Vranishtë:

- Kërkojmë që ta hiqni fshatin Vranishtë nga projekti i Ujësjellësit kryesor.

Nedžmidin Sejdić, asambleist i Kuvendit Komunal në Dragash:

- Lista e fshatrave të përfshira në projektin e Ujësjellësit kryesor ka qenë nga viti 2012. Prej atëherë shumë fshatra kanë bërë zgjidhje për ujin. Ato mjete duhet të destinohen për projekte të tjera.

Zuhrem Pajaziti, banor i fshatit Libevishtë:

- Kemi nevojë për polica të shtrira në rrugë.

Florian Hyseni, banor i fshatit Shajne:

- Fshati Shajne ka ngarkesë të madhe me Rrugën Unazore, nëse ka mundësi të bëhet zgjerimi i kësaj rruge.
- Të instalohet ndriçimi publik për fshatin Shajne.

Sinap Selmani, banor i Dragashit:

- Propozoj që përgjatë rrugës për në Stadiumin e qytetit të bëhen edhe disa pushimore.

Nazim Dauti, banor i Dragashit:

- Propozoj që të ndërtohen vende të caktuara për vendosjen e kontenierëve për mbeturina.

Lista e nënshkrimeve të pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë

LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIM BUXHETOR

Vendi: DRAGASH

Data: 22.08.2023

Nr.	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1	BEKEI QURAJ	DRAGASH	
2	ZHUREM PASAZIÇI	HUBOVISTE	
3	EDRUP JACIPI	DRAGASH	
4	ELIUR MEMISI	VPRANISHTA	
5	SULAP SEEMANI	DRAGASH	
6	SELDIU JELMAZI	RADESA	
7	MERSIN ASYARI	RADESA	
8	MIRIM DAVOVI	DRAGASH	
9	SHAKIRI DUTI	VEROUE	
10	MASEM SAUTI	DRAGASH	
11	AMRIT JORUN	RADESA	
12	SHARDA ELWAZI	Ullevë - Preseduro	
13	FINN SMITHI	DRAGASH	
14	REXHEP BOJAKUZI	PILAVE	
15	FLORIAN HUSHI	SHADNE	
16	AJHAN BECIRI	Rapca / Radesa / Dragash	
17	VALONIDA JAGULLI	PN	
18	SENAID FETA	RAPCA	
19	KAMIDI KAMBERI	RAPCA	
20	MENDA LUTVI	RAPCA	
21	FENGAP ZAJMI	Radesa	
22	AGATA ZAJMI	RTK	
23	SALIT ZECIRI	Radesa	
24	SKRIM ESOFI	KERKLEJON	

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
 Komuna e Dragashit
 Opština Dragash

02 Nr. Br. 400/01-21970/23
22.08.2023
 Dragash - Dragash



